




unitar

United Nations Institute for Training and Research



Projekti "Forcimi i Kapaciteteve për Zbatimin e Qasjes Ndërkombëtare Strategjike për Menaxhimin e Kimikateve (SAICM) në Shqipëri"

2011-2013



Përfshirja e palëve të interesuara në menaxhimin e kimikateve në Shqipëri

(Dokument politik)

Përmbajtja e lëndës:

Përfshirja e palëve të interesuara në menaxhimin e kimikateve në Shqipëri	2
1. Hyrje	2
2. Objektivi dhe metodologjia e përgatitjes së dokumentit politik të përfshirjes së aktorëve në menaxhimin e kimikateve.....	3
3. Pjesëmarrja e aktorëve në menaxhimin e kimikateve	3
4. Shkurtime	9



Përfshirja e palëve të interesuara në menaxhimin e kimikateve në Shqipëri

1. Hyrje

Qasja Ndërkombëtare Strategjike për Menaxhimin e Kimikateve (SAICM¹) u mandatua nga UNEP dhe u nxit nga Mbledhja Botërore mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm e Johannesburgut në 2002 si dhe Samiti Botëror në New York, në Shtator 2005. Ajo u nis nga një iniciativë e një komiteti përgatitor shumëpalësh të rimbledhur nga UNEP, IFC dhe IOMC. Termi “Qasje Ndërkombëtare Strategjike ndaj Menaxhimit të Kimikateve” (SAICM) u shfaq dhe u përdor në Konferencën I Ndërkombëtare të Menaxhimit të Kimikateve në Dubai, 2006. SAICM paraqet një strategji gjithëpërfshirëse ndaj problemeve të menaxhimit të kimikateve në rang kombëtar dhe global.

Objektivi kryesor i SAICM është mirë-menaxhimi i kimikateve gjatë gjithë ciklit jetësor të tyre me qëllim që deri në vitin 2020 kimikatet të prodhohen dhe përdoren në mënyra të tilla që të minimizohen konsiderueshëm efektet që ato shkaktojnë ndaj shëndetit njerëzor dhe mjedisit. Përfshirja e të gjithë aktorëve të përfshirë direkt apo indirekt në menaxhimin e kimikateve është një nga anët e forta të SAICM si një nismë gjithëpërfshirëse në fushën e menaxhimit të kimikateve.

Një ndër dokumentat kryesore ku bazohen veprimtaritë në kuadër të SAICM është Plani Global i Veprimit, ku përcaktohen fusha të punës, aktivitete, indikatorë të progresit, aspekte të zbatimit dhe terma kohorë. Ky dokument është orientues për veprimtaritë lidhur me kimikatet në nivele të ndryshme, duke shkuar nga ai global, rajonal, kombëtar e deri në atë lokal. Ky dokument bazë i SAICM ka shërbyer si bazë nisjeje për përgatitjen e këtij dokumenti mbi përfshirjen e aktorëve në menaxhimin e kimikateve, ku janë përzgjedhur aktivitetet e konsideruara më urgjente dhe më të realizueshme në kontekstin e vendit.

Ky dokument mbi përfshirjen e palëve të interesuara në menaxhimin e kimikateve në Shqipëri u përgatit në kuadër të projektit “Forcimi i kapaciteteve për zbatimin e Qasjes Ndërkombëtare Strategjike (SAICM) në Shqipëri”, 2011-2013, me mbështetjen metodologjike të Institutit të Kombeve të Bashkuara për Trajnime dhe Kërkim (UNITAR).

¹ Strategic Approach to International Chemicals Management



2. Objektivi dhe metodologjia e përgatitjes së dokumentit politik të përfshirjes së aktorëve në menaxhimin e kimikateve

Qëllimi i këtij dokumenti është orientimi dhe ndihma ndaj përpjekjeve të ardhme kombëtare dhe ndërkombëtare për përmirësimin e menaxhimit të kimikateve në vend, nëpërmjet orientimit të aktorëve kontribues potencialë për identifikimin e partnerëve me interesa dhe fushë ekspertize specifike. Ky dokument është komplementar me Profilin Kombëtar të Menaxhimit të Kimikateve të rishikuar, në kapitullin 4 dhe 5 të të cilit janë shtjelluar institucionet dhe agjencitë shtetërore, si dhe të gjithë aktorët e tjerë nga universitetet, OJQ dhe industria.

Metodologjia e përgatitjes së këtij dokumenti u bazua në prezantimin e UNITAR në takimin e dt. 24-25 mars 2012 për hapjen e projektit “Forcimi i kapaciteteve për zbatimin e SAICM në Shqipëri”, zhvilluar në Tiranë, si dhe në planin Global të Veprimeve të SAICM, prej të cilit janë përzgjedhur aktivitetet e konsideruara më urgjente dhe më të realizueshme në kontekstin e vendit.

Drafti I parë i këtij dokumenti u rishikua dhe u plotësua nga pjesëmarrësit në takimin e rishikimit të progresit të projektit, mbajtur me dt. 9-10 shkurt 2012 në Tiranë, duke përfaqësuar kështu kontributin e aktorëve nga fushat e ndryshme të menaxhimit të kimikateve: pushteti qendror, pushteti lokal, akademia, shoqëria civile, industria. Ky dokument është vazhdimësi e përpjekjeve të shumta për përfshirjen e gjithë palëve dhe aktorëve në vend që merren direkt apo indirekt me menaxhimin e kimikateve gjatë realizimit të aktiviteteve të projektit të sipërpërmendur.

3. Pjesëmarrja e aktorëve në menaxhimin e kimikateve

Një analizë e hollësishme e aktorëve të përfshirë aktualisht në menaxhimin e kimikateve në Shqipëri, e funksioneve dhe detyrave që ata mbulojnë, bëhet në kapitujt 4 dhe 5 të Profilin Kombëtar të Kimikateve të rifreskuar në vitin 2012. Në kapitujt e tjerë të profilit përshkruhen aktivitetet e tyre, si dhe është bërë vlerësimi i kapaciteteve.

Në tabelën A paraqitet e përmbledhur problematika kryesore kombëtare lidhur me përfshirjen e aktorëve në menaxhimin e kimikateve dhe propozohen masat që mund të ndërmerren për përmirësimin e gjendjes.



Tabela A: Problematika kryesore kombëtare lidhur me përfshirjen e aktorëve, dhe masat që propozohet të ndërmerren për përmirësimin e gjendjes.

Problematika	Çështjet dhe mangësitë aktuale	Masa që mund të ndërmerren për përmirësimin e gjendjes
1. Kontributi i aktorëve të ndryshëm	Kontributi i palëve të ndryshme nuk është i vazhdueshëm dhe shpesh herë është i diktuar nga ngjarje të ndryshme	Promovim i përfshirjes së palëve, ndërgjegjësim, trajnime
	Aftësitë, eksperiencat dhe ekspertizat e palëve të ndryshme nuk mbledhen siç duhet, sidomos në sektorin privat	Promovim i aktiviteteve për ndërtimin e kapaciteteve në sektorin privat; Ndihmë financiare dhe teknike për formimin e grupeve të interesit për çështjet e kimikateve; Forcim i zbatimit të detyrimeve të industrisë
2. Shkëmbimi i të dhënave dhe shpërndarjes së informacionit palëve të interesuara	Mungesë apo mangësi e të dhënave për menaxhimin e kimikateve dhe sigurinë kimike; Mungon infrastruktura për shkëmbimin e të dhënave, sidomos në nivel lokal	Ngritja e bazave të të dhënave; promovimi i mekanizmave të shkëmbimit të informacionit (faqe interneti, faqe sociale, etj.); Përmirësim i infrastrukturës
3. Harmonizimi i interesave të palëve të ndryshme	Vëmendje duhet t'u kushtohen çështjeve që kanë rëndësi për publikun	Përmirësim i koordinimit
4. Rolet e aktorëve të ndryshëm	Mbivendosja apo mungesa e roleve të aktorëve të ndryshëm	Rishikimi i legjislacionit
5. Pjesëmarrja e gupeve jo-qeveritare	Ekspertizë e kufizuar	Trajnime



Në Tabelën B janë paraqitur aktorët e angazhuar konkretisht dhe potencialisht në fushat e punës të Planit Global të Veprimeve të SAICM, ku janë përzgjedhur aktivitetet e konsideruara më urgjente dhe më të realizueshme në kontekstin e vendit.

Tabela B: Aktorët e angazhuar konkretisht dhe potencialisht sipas fushave të punës të Planit Global të Veprimeve të SAICM


Fushat e punës	Agjencia/ aktori kryesor	Agjenci/ aktorë të tjerë
1. Vlerësimi i menaxhimit të kimikateve në shkallë kombëtare për të identifikuar mangësitë dhe për të nxjerrë prioritetet	Projekti SAICM	Ministritë dhe agjencitë e përfshira në menaxhimin e kimikateve; OJQ, universitetet, industria, organizmat ndërqeveritarë ndërkombëtarë
2. Mbrojtja e shëndetit të njeriut	MSh	IShP, DShP-të e rretheve, Inspektorati Sanitar Shtetëror, Pushteti vendor, OJQ, OBSH, media
3. Fëmijët dhe siguria ndaj kimikateve	MSh	MASh, IShP - Departamenti i Promocionit, UNICEF, OJQ, media, IZHA (Inst. Zhvillimit të Arsimit)
4. Shëndeti dhe siguria në punë	MSh	Inspektoratet (Sanitar dhe i Punës), MPÇSShB, MMPAU (per aksidentet), IShP, Sindikatat, ILO (International Labour Organization) Sektori privat, industrite
5. Implementimi i Sistemit të Harmonizuar Botëror të Klasifikimit dhe Etiketimit të Kimikateve (GHS)	MMPAU (Agjencia e Kimikateve ¹)	Industria, MSh, MBUMK, Doganat
6. Menaxhimi i riskut të pesticideve me toksicitet të lartë dhe zbutja e efekteve të tyre	MBUMK	ISUV, MSh, Qendra Kombëtare e Licensimit, Inspektorët, OBSH, importuesit, dogana, Komisioni i Regjistrimit të PMB-ve



Fushat e punës	Agjencia/ aktori kryesor	Agjenci/ aktorë të tjerë
7. Programet për pesticidet	MBUMK	ISUV, Universitetet (UBT), IShP, DShP-të e rretheve, OJQ
8. Shëndeti i dobësuar dhe rreziqet mjedisore të pesticideve	MBUMK	MSh, MMPAU, ISUV, Universitetet (UBT), IShP, DShP-të e rretheve, OJQ
9. Prodhimi i pastër	MMPAU	METE, UNIDO, ECAT, AMP, MBUMK, Industria
10. Rehabilitimi i zonave të ndotura	MMPAU	METE, donatorët , AMP
11. Plumbi në benzinë	MMPAU	Inspektorati Qendror Teknik
12. Praktikrat e mira bujqësore	MBUMK	UBT, Shoqatat e fermerëve
13. Substanca persistente, bioakumulative dhe toksike; substancat shumë persistente dhe shumë bioakumulative; kimikate që janë kancerogjene apo mutagjene apo ato që kanë efekte negative, ndër të tjerat tek sistemi riprodhues, endokrin, imunitar apo nervor. Ndotësit organikë të qëndrueshëm.	MMPAU	MSh, IShP, universitetet, OJQ
14. Mërkuri si dhe kimikate të tjerë të shqetësimit global; kimikate të prodhuara dhe të përdorura në volume të mëdha; kimikate me përdorim të shpërndarjes së gjerë si dhe kimikate të tjera të problematikës në nivelet kombëtare	MMPAU	MSh, METE
15. Vlerësimi i riskut, menaxhimi dhe komunikimi	MSh, MMPAU	AMP, IShP, IHR, media, OJQ
16. Menaxhimi i mbetjeve (dhe minimizimi i efekteve të tyre)	MMPAU	MPPT, AMP, ARM, sektori privat



Fushat e punës	Agjencia/ aktori kryesor	Agjenci/ aktorë të tjerë
17. Formulimi i masave parandaluese për të zbutur impaktin e urgjencave kimike në shëndetin njerëzor dhe mjedisor	MSh, MMPAU	IShP-IHR (International Health Regulations) , AMP, Kryqi i Kuq, MB- QKOEK (Qendra Kombëtare operacionale e Emergjencave Civile)
18. Kërkime, monitorime	MMPAU	ISUV, AMP, IShP, MSh, institute të tjerë, universitetet, Doganat
19. Gjenerimi dhe disponibiliteti i të dhënave për rreziqet	Zyra e Kimikateve ⁱ	Industria, AMP, ARM, MSh
20. Promovimi i pjesëmarrjes së industrisë dhe përgjegjësitë	Dhomat e Tregtisë	METE, AIDA (Agjencia per Zhvillim industrial)
21. Menaxhimi dhe shpërndarja e informacionit	Zyra e Kimikateve ⁱ	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, INSTAT, ministrinë e linjës
22. Cikli jetësor I kimikateve	Zyra e Kimikateve ⁱ	MSh, MMPAU, METE, MBUMK, doganat, MPPT, Dhomat e Tregtisë, Shoqata e Mbrojtjes së Konsumatorëve
23. Regjistrat e çlirimit dhe transferimit të ndotësve; krijimi i regjistrave kombëtarë	MMPAU	AMP, Inspektorati i Mjedisit, ARM, Industria
24. Edukimi dhe trajnimi (ndërgjegjësimi i publikut)	IShP- Departamenti i Promocionit	MMPAU, MASH, OJQ , media, Fakulteti i Mjekësisë -Departamenti i Shëndetit Publik
25. Pjesëmarrja e palëve të interesuara	Komitet ndersektorial	Ministrite e linjës, OJQ, universitetet, industria, etj.
26. Zbatimi i programeve kombëtare të integruara për mirëmenaxhimin e	Zyra e Kimikateve ⁱ	Ministrite e linjës, UNDP, OBSH, UNIDO, OSBE,



Fushat e punës	Agjencia/ aktori kryesor	Agjenci/ aktorë të tjerë
kimikateve në nivel kombëtar		
27. Marrëveshjet ndërkombëtare	MMPAU	Ministria e Jashtme, ministritë e linjës
28. Konsiderata ekonomike dhe sociale	Ministria e Financës	Ministritë e linjës, sektori privat (industria)
29. Aspekte ligjore, të politikave dhe institucionale	MMPAU	Zyra e Kimikateve ⁱ , projektet e përafrimit të legjislacionit me atë të BE
30. Detyrimet dhe kompensimi	Inspektorati i Mjedisit	AMP, MF, MMPAU, MSh, MBUMK, MPÇSShB
31. Inventarizimi dhe ndjekja e progresit (Zhvillimi I indikatorëve objektivë për vlerësimin e ndikimit të kimikateve në shëndetin njerzor dhe mjedisor)	MSh	MMPAU, IShP, AMP
32. Zonat e mbrojtura	MMPAU	AMP, ARM, Pushteti vendor
33. Parandalimi i trafikut të jashtëligjshëm të produkteve toksike dhe të rrezikshme	Doganat	Inspektoratet në pikat kufitare
34. Tregtia dhe mjedisi	METE	MMPAU, MBUMK, MSh, inspektoratet
35. Përfshirja e shoqërisë civile dhe grupeve të interesit, organizatave jo- qeveritare (OJQ)	MMPAU, Zyra e kimikateve ⁱ	Komiteti Ndërsektorial për Menaxhimin e Kimikateve
36. Ndërtimi i kapaciteteve për të mbështetur veprimtaritë kombëtare	MMPAU	MSh, AMP, IShP, universitetet, OJQ, institutet e tjerë



4. Shkurtime

AIDA	Agjensia për Zhvillim Industrial
AMP	Agjensia e Mjedisit dhe Pyjeve
ARM	Agjencitë Rajonale të Mjedisit
BE	Bashkimi European
DShP	Drejtoritë e Shëndetit Publik
ECAT	Environmental Center for Administration and Technology
GHS	Globally Harmonized System for classification, labeling and packaging of chemicals
IFC	International Finance Centre
IHR	International Health Regulations
ILO	International Labour Organization
INSTAT	Instituti i Statistikave
IOMC	Inter -Organization Programme for the Sound Management of Chemicals
IQT	Inspektoriati Qendror Teknik
IShP	Instituti i Shëndetit Publik
ISUV	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare
IZhA	Instituti i Zhvillimit të Arsimit
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MBUMK	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
METE	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës
MF	Ministria e Financave



MMPAU	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave
MPÇSSH	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
MPPT	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJQ	Organizatë/organizatat Jo-Qeveritare
OSBE	Organizata për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Europë
PMB	Produkt për Mbrojtjen e Bimëve
QKOEK	Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile
SAICM	Strategic Approach to International Chemicals Management
ToR	Terms of Reference
UBT	Universiteti Bujqësor i Tiranës
UNDP	United Nations Developing Programme
UNEP	United Nations Environmental Programme
UNICEF	United Nations Children's Fund
UNIDO	United Nations Industrial Development Organization

ⁱ Apo emri i institucionit përkatës që do krijohet për menaxhimin e kimikateve, bazuar në Ligjin 9108, datë 17.07.2003 “Për substancat dhe preparatet kimike”